



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Nr. 1896 prot.

Puke , me 09 .10. 2024

Procesverbal

i mbledhjes se kryesise se keshillit , i mbajtur sot me date 09. 10.2024 :
Te njoftuar per mbledhje :

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Dritan Asani
4. Besar Kuçi
5. Alfons Gjergj
6. Hazbi Terbuni

Moren pjese:

1. Gjon Gjoka
2. Dritan Asani
3. Besar Kuçi
4. Hazbi Terbuni

Tematika e mbledhjes eshte : Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së rradhës të Këshillit Bashkiak” per muajin Shtator –Tetor 2024.

Mbledhjen e hapi kryetari i keshillit z. Gjon Gjoka, i cili prezantoi projekt-rendin e dites te pergatitur paraprakisht ne bashkepunim me kryetarin e Bashkise dhe administraten e bashkise si me poshte vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 16.08.2024
2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Korrik 2024**.
3. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Gusht 2024**
4. Projekt Vendim “Për emërtim rruge në territorin e Bashkisë Pukë
5. Projekt vendim “Për vendosje memoriali” në qytetin e Pukës

6. Projekt - vendim “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë Pukë dhe institucioneve të varësisë”
7. Projekt- vendim për dhënien e pëlqimit për fillimin e procedurave për shitjen me ankand të aksioneve të klubit të futbollit “FK Terbuni” ShA me NIPT : L19704301F në masën 100%.
8. Projekt-vendim “ Për një shtesë në VKB nr. 47 datë 29.12.2023 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 “ i ndryshuar.
9. Projekt vendim “ Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Pukë për akordimin e ndihmës së menjëherëshme financiare së bashku me dokumentacion tekniko-ligjor për familjen e z. Ardian Keci , banesa e të cilit është dëmtuar nga renie zjarri(djegie), nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile dhe fondi i emergjencave civile, buxheti i Bashkisë Pukë”
10. Projekt vendim “ Për miratimin e buxhetit faktik për 8-mujorin , viti 2024”
11. Projekt vendim “ Për një shtesë në VKB nr 6 date datë 09,02.2024 “ Për miratimin e dhënies në përdorim nga fondi pyjor të një sipërfaqe pyjore publike prej 6.65 Ha në ekonominë pyjore Kryezi -Bicaj”
12. Projekt Vendim “ Për dhënie në përdorim me afat 10 vjet, sipërfaqe pyjore prej 17 Ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, turistike, sportive dhe kulturore” në parcelën nr. 5/a, ekonomia pyjpre Gomsiqe, parcelën nr. 93/a dhe 101/a të ekonomisë pyjore Krrab-Bushat, në parcelën 23/b të ekonomisë pyjore Terhun.
13. Projekt Vendim Rishqyrtim i VKB nr. 22 date 29.05.2024 “ Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 16 date 05.05.2022” Për dhënien e dakortesisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor , kullësor publik për 0.02 Ha për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike eolike 2 MW nga shoqëria “Dembacaj 2020 Shp.k.”
14. Projekt Vendim “ Rishqyrtim i VKB nr.35 datë 16.08.2024 “ Për dhënien në përdorim nga fondi pyjor për shesh depozitimi të përkoheshëm të materialeve të ndryshme , të sipërfaqes 0.2 Ha në parcelen 28/A në ekonominë pyjore Munellë”
15. Projekt Vendim “ Për miratimin e marrëveshjes (TIP)me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”

16. Për një shtesë në VKB nr. 38 datë 06.12.2024 “Për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave në Bashkinë Pukë” (Fshati Puke dhe fshati Qerret)

17. Projekt Vendim “Per miratimin e projektit me objekt: “Masa parandaluese tëcë gërryerjes së tokave bujqësore dhe kanaleve vaditëse nga ujrat e larta dhe sistemimi i tyre , njesia administrative Gjegjan , Bashkia Pukë” me fondin e keshtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

18. Të tjera.

Perfundimisht kryesia vendosi te marre : Vendimin nr.3 date 09.10.2024, ku u percaktua data dhe ora e zhvillimit te mbledhjes se keshillit, data dhe ora e mbledhjes se komisioneve te perhereshme te keshillit detyrat per sekretarin e keshillit per berjen publike te njoftimit dhe dergimin e materialeve te pergatitura per mbledhjen e keshillit , sipas rendit te dites se miratuar nga kryesia sic eshte prezantuar me lart nga Kryetari i Keshillit.

Shënim: Mbledhja e komisioneve te perhereshme te keshillit zhvillohet më datë 15 .10.2024 , ne oren 14-⁰⁰ në zyrën e sekretarit të këshillit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Gjon Gjoka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK
KRYESIA

VENDIM

Nr. 3 datë 09 .10 .2024

**“PËR
MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES SË RADHËS SË KËSHILLIT BASHKIAK”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr.14 datë 30/06/2020, neni 57, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 09. 10. 2024;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 16 . 10. 2024, ora 13.³⁰.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit të rendit të ditës, si dhe dosjen me materialet e mbledhjes tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Të pranishëm ne mbledhje:

1. Gjon Gjoka
2. Dritan Asani
3. Besar Kuci
4. Hazbi Terbuni

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Gjon Gjoka

